



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 77

Tiranë – E hënë, 5 maj 2025

PËRMBAJTJA

Vendim i Këshillit të Ministrave
nr. 252, datë 2.5.2025

Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësisë e të marrëdhënieve
midis autoriteteve dhe strukturave përgjegjëse për koordinimin dhe
raportimin, sipas parashikimeve të marrëveshjes së facilitetit,
ratifikuar me ligjin nr. 19/2025.....

Faqe

8279

**VENDIM**

Nr. 252, datë 2.5.2025

**PËR PËRCAKTIMIN E FUNKSIONEVE,
TË PËRGJEGJËSIVE E TË
MARRËDHËNIEVE MIDIS
AUTORITETEVE DHE STRUKTURAVE
PËRGJEGJËSE PËR KOORDINIMIN DHE
RAPORTIMIN, SIPAS PARASHIKIMEVE
TË MARRËVESHJES SË FACILITETIT,
RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 19/2025**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2, të ligjit nr. 19/2025, “Për ratifikimin e marrëveshjes së facilitetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Bashkimit Evropian, të përfaqësuar nga Komisioni, për rregullimet specifike për zbatimin e mbështetjes së Bashkimit Evropian për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të facilitetit për reforma dhe rritje”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**Neni 1****Objekti**

Ky vendim përcakton:

a) funksionet, përgjegjësitë e marrëdhëniet midis autoriteteve dhe strukturave për menaxhimin e asistencës financiare të dhënë nga Bashkimi Evropian për Republikën e Shqipërisë, në bazë të marrëveshjes së financimit që lidhet me zbatimin e mbështetjes së Bashkimit Evropian për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të facilitetit për reforma dhe rritje (Instrumenti RGF), në përputhje me Agjendën Kombëtare të Reformave 2024–2027, të miratuar me vendimin nr. 621, datë 10.10.2024, të Këshillit të Ministrave, dhe me ligjin nr. 19/2025, “Për ratifikimin e marrëveshjes së facilitetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Bashkimit Evropian, të përfaqësuar nga Komisioni, për rregullimet specifike për zbatimin e mbështetjes së Bashkimit Evropian për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të facilitetit për reforma dhe rritje”;

b) autoritetet dhe strukturat e ngarkuara me koordinimin, zbatimin, menaxhimin financiar, monitorimin, vlerësimin dhe raportimin,

transparencën, mbrojtjen e të dhënave dhe vizibilitetin, mbikëqyrjen, kontrollin dhe auditimin e Instrumentit RGF;

c) mekanizmat për të garantuar zbatimin e duhur të Instrumentit RGF.

Neni 2**Përkufizimet**

Termat e përdorur në këtë vendim lidhur me Instrumentin RGF kanë të njëjtin kuptim si në marrëveshjen e ratifikuar me ligjin nr. 19/2025.

Neni 3**Strukturat dhe autoritetet**

1. Për menaxhimin dhe zbatimin e asistencës financiare në kuadër të Instrumentit RGF, ngarkohen me përgjegjësi strukturat dhe autoritetet e mëposhtme:

a) Koordinatori Kombëtar për Facilitetin e Reformave dhe Rritjes, në vijim “Koordinatori Kombëtar (KK)”;

b) Zyra Mbështetëse e Koordinatorit Kombëtar (ZMKK);

c) Komiteti i Planifikimit Strategjik (KPS);

ç) Komiteti Monitorues i RGF-së;

d) Strukturat e krijuara ose strukturat e ngarkuara pranë ministrisë përgjegjëse për financat për të siguruar zbatimin e marrëveshjes së huas, ratifikuar me ligjin nr. 18/2025 (këtu e në vijim “marrëveshja e huas”) dhe funksionet e pagesave sipas marrëveshjes së facilitetit dhe marrëveshjes së huas;

dh) Ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera publike të përcaktuara në Agjendën Kombëtare të Reformave 2024–2027, përgjegjëse për monitorimin dhe raportimin mbi realizimin e hapave të reformës;

e) Ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera publike të identifikuara për përgatitjen dhe zbatimin e investimeve të Kuadrit të Investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF);

ë) Agjencia për Media dhe Informim (MIA);

f) Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI);

g) Struktura pranë ministrisë përgjegjëse për financat, e ngarkuar me hartimin e Deklaratës së Menaxhimit dhe Përmbledhjes së Auditimeve;

gj) Struktura pranë ministrisë përgjegjëse për financat, e ngarkuar me mbikëqyrjen dhe raportimin mbi funksionimin e Sistemit të Kontrollit të



Brendshëm, në përputhje me nenin 9, të marrëveshjes së facilitetit;

h) Shërbimi i Koordinimit kundër Mashtrimit, brenda ministrisë përgjegjëse për financat.

2. Autoritetet dhe strukturat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, që nuk janë krijuar ende, konstituohen pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe ushtrojnë detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në të.

3. Për të siguruar bashkëpunimin ndërsektorial dhe integrimin e politikave për zbatimin e reformave dhe investimeve specifike në kuadër të Instrumentit RGF, me nismën e ministrive të linjës, mund të krijohen grupe ndërministrorë dhe/ose ndërinstitutionale të punës.

4. Ministrinë e linjës mund t'i propozojnë Koordinatorit Kombëtar krijimin e grupeve të tjera të punës ndërministrorë dhe/ose ndërinstitutionale, sipas nevojës për masa/hapa specifikë të Agjendës së Reformave.

5. Çdo institucion i përfshirë në proceset e trajtuara në këtë vendim duhet të sigurojë që strukturat përkatëse të ngarkuara me zbatimin e Instrumentit RGF të jenë qartësisht të identifikuara dhe të ushtrojnë të gjitha funksionet përkatëse, përfshirë raportimin dhe monitorimin.

6. Çdo strukturë dhe autoritet, që zbaton funksione dhe detyra në kuadër të Instrumentit RGF, duhet të njoftojë pranë Koordinatorit Kombëtar strukturat e caktuara e personat e kontaktit, si dhe funksionet, detyrat e përgjegjësitë përkatëse që u janë caktuar sipas Instrumentit RGF.

Neni 4

Koordinimi i zbatimit të Instrumentit RGF

1. Funksionet e Koordinatorit Kombëtar të Facilitetit të Reformës dhe Rritjes, të përcaktuara në nenin 5, të marrëveshjes së facilitetit, do të ushtrohen nga drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore për Planifikimin Strategjik dhe Koordinimin e Ndhmës (në vijim “SASPAC”), i cili është njëkohësisht Koordinator Kombëtar i Asistencës së Bashkimit Evropian për Paraanëtarësim (në vijim “KKIPA”).

2. Në përmbushjen e përgjegjësiave të tij/saj, Koordinatori Kombëtar asistohet nga zyra mbështetëse e tij, si një strukturë që krijohet brenda SASPAC-ut, me këto detyra:

a) Të bashkërendojë dhe të koordinojë punën me ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera publike, të përcaktuara në Agjendën Kombëtare të Reformave (në vijim “AKR”) 2024–2027, si entitete përgjegjëse për zbatimin dhe raportimin mbi arritjen e hapave nën AKR 2024–2027, si dhe ministrinë e linjës dhe institucionet publike të identifikuara për përgatitjen dhe zbatimin e investimeve, në kuadër të Kornizës së Investimeve për Ballkanin Perëndimor, në përgatitjen e një plani të detajuar për zbatimin dhe raportimin mbi AKR 2024–2027, sipas Instrumentit RGF, brenda një muaji nga miratimi i këtij vendimi.

b) Të bashkërendojë me strukturat dhe autoritetet e listuara në nenin 3 të këtij vendimi për përgatitjen e raporteve të monitorimit mbi përmbushjen e hapave të reformave (cilësorë dhe sasiorë), të përcaktuar në kuadër të AKR-së së miratuar, në bashkëpunim me ministrinë e linjës dhe institucionet publike përgjegjëse për përmbushjen e hapave të reformave (cilësorë dhe sasiorë), të përcaktuar në kuadër të AKR-së së miratuar. Raportet e monitorimit do të përshkruajnë, gjithashtu, verifikimet e kryera për të konfirmuar që masat e lidhura me të njëjtat reforma, për të cilat përfituesi kishte arritur një përmbushje të kënaqshme, janë të qëndrueshme.

c) Të ofrojë këshilla dhe mbështetje teknike për ministrinë e linjës dhe institucionet përkatëse mbi standardet e raportimit.

ç) Të menaxhojë të dhënat dhe të rishikojë raportet e ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera publike mbi zbatimin e reformave dhe investimeve për periudhën 2024–2027, në kuadër të Instrumentit RGF.

d) Të përgatisë kërkesat për lëshimin e fondeve sipas Instrumentit RGF.

dh) Të trajtojë procesin e bashkëpunimit të kërkesave për pagesa sipas marrëveshjes së huas.

e) T'i përcjellë pa vonesë Komisionit kopjet e marrëveshjeve të kontributit, të nënshkruara nga ministria përgjegjëse për financat me menaxherët e fondeve dhe provat e disbursimit në EWB/JF, siç përcaktohet në nenin 20 të marrëveshjes së facilitetit.

ë) Të zbatojë funksionet e sekretariatit teknik për Komitetin e Monitorimit të Instrumentit të Reformës dhe Rritjes, të krijuar sipas nenit 25 të marrëveshjes së facilitetit.

f) Të zbatojë në koordinim me MIA-n, Planin e Komunikimit dhe Vizibilitetit në bashkëpunim me ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera publike, të



përcaktuara në Agjendën Kombëtare të Reformave, si entitete përgjegjëse për komunikimin e zbatimit dhe raportimit mbi arritjen e hapave nën AKR.

g) Të ndjekë procedurat, si dhe të përgatitë udhëzimet dhe aktet, që miratohen nga Koordinatori Kombëtar.

gj) Të bashkëpunojë me Agjencinë Kombëtare të Shqipërisë së Informacionit në konceptimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e modulit të facilitetit për reforma dhe rritje, me qëllim menaxhimin, monitorimin, raportimin dhe kontrollin e përgjithshëm të procesit të RFG-së.

3. Koordinatori Kombëtar është përfutuesi i asistencës teknike të ofruar nga Bashkimi Evropian për monitorimin dhe koordinimin e zbatimit të reformave dhe investimeve të planifikuara në Agjendën Kombëtare të Reformave 2024–2027, në kuadër të Instrumentit RGF, dhe do të koordinojë këtë asistencë me të gjitha strukturat dhe autoritetet e angazhuara.

Neni 5

Zbatimi i reformave dhe investimeve

1. Ministritë e linjës dhe institucionet e tjera publike, të përcaktuara në Agjendën Kombëtare të Reformave, si dhe ministritë e linjës dhe institucionet publike të identifikuar për përgatitjen dhe zbatimin e investimeve të Kuadrit të Investimeve për Ballkanin Perëndimor janë përgjegjëse për raportimin ndaj Koordinatorit Kombëtar mbi zbatimin e reformave dhe masave, në kuadër të Instrumentit RGF.

2. Ministritë e linjës dhe institucionet e tjera publike, të përcaktuara në Agjendën Kombëtare të Reformave si entitete përgjegjëse për zbatimin dhe raportimin mbi arritjen e hapave, sipas Agjendës Kombëtare të Reformave, si dhe ministritë e linjës dhe institucionet publike të identifikuar për përgatitjen dhe zbatimin e investimeve, në kuadër të Kornizës së Investimeve për Ballkanin Perëndimor, duhet të përgatisin një plan të detajuar për zbatimin në kohë të Agjendës Kombëtare të Reformave 2024–2027 (AKR) në kuadër të Instrumentit RGF. Ky plan duhet t'i komunikohet Koordinatorit Kombëtar brenda një muaji nga miratimi i këtij vendimi.

3. Plan i hartuar në përputhje me këtë nen duhet të përditësohet të paktën çdo tre muaj, sipas nevojës. Çdo version i përditësuar i planit duhet t'i përcillet

Koordinatorit Kombëtar brenda 15 ditëve nga përditësimi i tij.

4. Ministritë e linjës dhe institucionet publike, të listuara në Agjendën Kombëtare të Reformave, duhet:

a) të zbatojnë reformat dhe investimet e përcaktuara në AKR;

b) të sigurojnë përmbushjen e kënaqshme të hapave përkatës cilësorë/sasiorë të identifikuar për zbatimin e Agjendës Kombëtare të Reformave 2024–2027, në përputhje me kriteret dhe standardet e zbatueshme, duke respektuar afatet e përcaktuara në Agjendën Kombëtare të Reformave;

c) të bashkëpunojnë në mënyrë të vazhdueshme me Koordinatorin Kombëtar dhe Zyrën e Mbështetjes të Koordinatorit Kombëtar për të lehtësuar zgjidhjen në kohë të çështjeve që mund të shfaqen dhe për të siguruar zbatimin e suksesshëm të reformave dhe investimeve;

ç) të sigurojnë të gjitha provat e nevojshme për të treguar zbatimin e reformave dhe investimeve të planifikuara në Agjendën Kombëtare të Reformave 2024–2027, në përputhje me Instrumentin RGF;

d) të verifikojnë e të deklarojnë se reformat e lidhura me të njëjtat masa e për të cilat përfutuesi ka arritur një përmbushje të kënaqshme, janë të qëndrueshme dhe sigurojnë parimin e pakthyeshmërisë;

dh) të krijojnë grupe të brendshme pune për të koordinuar dhe siguruar zbatimin e masave në kuadër të Agjendës Kombëtare të Reformave 2024–2027. Ministritë e linjës të përcaktojnë një zyrtar përgjegjës për zbatimin dhe raportimin e RGF-së, në nivel zëvendësministri, si pikë kontakti për masat e zbatuara apo bashkërenduara nën AKR;

e) të zhvillojnë takime teknike të rregullta me institucionet e tjera që zbatojnë çdo fushë politike, duke u fokusuar në ecurinë e zbatimit të reformave dhe investimeve, identifikimin e pengesave të mundshme, diskutimin mbi nevojën për asistencë teknike shtesë dhe përmirësimin e koordinimit ndërministror;

ë) të sigurojnë zbatimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm që fondet të jenë administruar në përputhje me të gjitha rregullat e zbatueshme, veçanërisht rregullat për shmangien e konflikteve të interesit, parandalimin e mashtrimit, korrupsionit dhe financimit të dyfishtë;

f) të zbatojnë procedurat e përcaktuara nga Koordinatori Kombëtar, me qëllim koordinimin e



përpjekjeve për të siguruar që fondet në kuadër të facilitetit të përdoren në përputhje me parimet e menaxhimit të mirë financiar, transparencës, trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit, për qëllimin për të cilin janë caktuar.

5. Për secilën nga fushat e politikave të listuara në vendimin nr. 621, datë 10.10.2024, të Këshillit të Ministrave, koordinimi dhe raportimi mbi zbatimin e reformave dhe investimeve do të sigurohet, si më poshtë:

a) Nga ministria përgjegjëse për politikën e mjedisit të biznesit, për reformat dhe investimet që lidhen me mjedisin e biznesit.

b) Nga ministritë përgjegjëse për politikën arsimore, për reformat dhe investimet në kapitalin njerëzor.

c) Nga ministria dhe institucionet përgjegjëse për politikën e digjitalizimit dhe telekomunikacionit, për reformat dhe investimet në sektorin digjital.

ç) Nga ministria përgjegjëse për politikën e infrastrukturës dhe energjisë, për reformat në sektorin e energjisë dhe tranzicionit të gjelbër, si dhe për investimet që lidhen me lidhjen infrastrukturore.

d) Nga ministria përgjegjëse për drejtësinë, për reformat dhe investimet që mbështesin sundimin e ligjit dhe të drejtat themelore.

6. Në rastet kur bashkëpunimi mes disa ministrive dhe/ose institucioneve publike është i nevojshëm, ministria përgjegjëse për një fushë të caktuar politike mund të propozojë krijimin e grupeve të punës ndërministrorë ose ndërinstitutionale për zbatimin e masave specifike.

Neni 6

Mbrojtja e interesave financiarë të Bashkimit Evropian

1. Strukturat dhe autoritetet e përcaktuara në nenin 3, që zbatojnë Instrumentin RGF, duhet:

a) të forcojnë vazhdimisht sistemet e menaxhimit të buxhetit në përputhje me parimet e njohura ndërkombëtarisht të kontrollit të brendshëm dhe të zbatojnë mekanizma të përshtatshëm për të parandaluar, zbuluar dhe korrigjuar në mënyrë efektive parregullsitë, mashtrimet, korrupsionin apo çdo veprimtari tjetër të paligjshme që cenon interesat financiarë të Bashkimit Evropian, duke përfshirë konfliktet e interesit dhe shmangien e financimit të dyfishtë;

b) të raportojnë mbi parregullsitë dhe të sigurojnë rikuperimin e menjëhershëm të shumave të paguara gabimisht ose të përdorura në mënyrë të pasaktë;

c) të lehtësojnë bashkëpunimin efektiv dhe shkëmbimin e informacionit me Komisionin Evropian, OLAF, Gjykatën Evropiane të Audituesve, Prokurorinë Publike Evropiane (EPPO) dhe të përdorin mbështetjen e Eurojust, sipas nevojës;

ç) të sigurojnë auditime të pavarura kombëtare mbi përdorimin e burimeve financiare të Instrumentit RGF;

d) të sigurojnë deklarata periodike të sigurisë mbi rezultatet e sistemeve kombëtare të kontrollit dhe auditimit;

dh) të sigurojnë transmetimin e të dhënave për përfituesit përfundimtarë në Komisionin Evropian në format elektronik të paktën një herë në vit, duke ndjekur modelin e ofruar nga Komisioni.

2. Në përputhje me nenin 9 të marrëveshjes së facilitetit, ministria përgjegjëse për financat do të caktojë një strukturë të brendshme, e cila do të ngarkohet me monitorimin e operacionalizimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, të referuara në të njëjtin nen.

3. Ministria përgjegjëse për financat do të koordinojë sistemin e parandalimit, zbulimit, raportimit dhe korrigjimit të parregullsive, mashtrimeve, korrupsionit apo çdo veprimtari tjetër të paligjshme që cenon interesat financiarë të Bashkimit Evropian, duke përfshirë konfliktet e interesit dhe shmangien e financimit të dyfishtë, si dhe rikuperimin e menjëhershëm të shumave të paguara gabimisht ose të përdorura në mënyrë të pasaktë. Raportimi duhet të kryhet në mënyrë sistematike ndaj Koordinatorit Kombëtar.

4. Ministritë e linjës dhe institucionet e tjera publike, të përcaktuara në Agjendën Kombëtare të Reformave si entitete përgjegjëse për zbatimin dhe raportimin mbi arritjen e hapave, do të caktojnë një zyrtar për parregullsitë, i cili do të jetë përgjegjës për përpunimin e sinjalizimeve dhe raportimin e parregullsive, si dhe për të siguruar që çdo parregullsi, duke përfshirë dyshime për mashtrim, mashtrim të konfirmuar, korrupsion dhe aktivitete të tjera të paligjshme që janë objekt i një vendimi administrativ ose gjyqësor fillestar, të raportohen pa vonesë në Komisionin Evropian përmes Sistemit të Menaxhimit të Parregullsive.



5. Ministritë e linjës dhe institucionet publike përkatëse do të sigurojnë akses të pakufizuar për Komisionin Evropian, OLAF, Gjykatën Evropiane të Audituesve dhe EPPO, në mënyrë që ata të ushtrojnë të drejtat dhe kompetencat e tyre të plota.

6. Ministria përgjegjëse për financat do të forcojë, gjithashtu, funksionimin e procedurave për raportimin e brendshëm dhe ndjekjen e shkeljeve të rregullave të vendosura në marrëveshjen e facilitetit dhe marrëveshjen e huas.

7. Brenda 6 muajve nga miratimi i këtij vendimi, ministria përgjegjëse për financat do të përfundojë protokollin e bashkëpunimit me institucionet përkatëse shqiptare për të siguruar që Komisioni Evropian, OLAF, Gjykata Evropiane e Audituesve dhe EPPO të ushtrojnë të drejtat e tyre dhe të kenë akses të plotë për të ushtruar kompetencat e tyre.

8. Ministria përgjegjëse për financat do të koordinojë bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit midis të gjitha strukturave dhe autoriteteve shqiptare me Koordinatorin Kombëtar, Komisionin Evropian, OLAF, Gjykatën Evropiane të Audituesve, EPPO dhe të përdorë mbështetjen e Eurojust, sipas nevojës.

9. Ministria përgjegjëse për financat do t'i dorëzojë Koordinatorit Kombëtar, dy herë në vit, evidencat përkatëse për nënshkrimin e Deklaratës së Sigurisë, sipas modelit të përcaktuar në marrëveshjen e facilitetit.

10. Koordinatori Kombëtar në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për financat do t'i dërgojë të dhënat për përfituesit përfundimtarë në Komisionin Evropian, të paktën një herë në vit.

Neni 7

Monitorimi dhe vlerësimi

1. Koordinatori Kombëtar do të vendosë një sistem monitorimi të rregullt dhe sistematik, si në nivel teknik, ashtu edhe në atë politik. Koordinatori Kombëtar së bashku me ministrinë përgjegjëse për financat do të organizojnë takime sistematike mujore me institucionet përgjegjëse për raportim në kuadër të Instrumentit RGF.

2. Koordinatori Kombëtar, i asistuar nga Zyra e Mbështetjes, do të monitorojë dhe do të vlerësojë zbatimin e reformave dhe investimeve të planifikuara në kuadër të Instrumentit RGF.

3. Koordinatori Kombëtar, në bashkëpunim me Komisionin Evropian, do të krijojë një Komitet

Monitorues të Instrumentit RGF, i cili do të bashkëkryesohet nga Koordinatori Kombëtar dhe përfaqësues të Komisionit Evropian.

4. Përfaqësues të shoqërisë civile dhe të komunitetit të biznesit janë, gjithashtu, pjesëmarrës në Komitetin Monitorues.

5. Komiteti Monitorues i Instrumentit RGF do të miratojë rregulloren e tij të funksionimit, duke përfshirë dispozita për parandalimin e çdo konflikti interesi dhe zbatimin e parimit të transparencës.

6. Komiteti Monitorues i RGF-së do të mbledhet të paktën një herë në vit dhe do të vlerësojë progresin në zbatimin e reformave dhe investimeve për arritjen e objektivave të Agjendës së Reformave.

7. Koordinatori Kombëtar do të drejtojë dhe do të udhëzojë kontributin e strukturave e të autoriteteve shqiptare në punën e Komitetit Monitorues dhe do t'i sigurojë Komitetit Monitorues, në mënyrë të përkohshme, të gjitha informacionet e nevojshme për kryerjen e detyrave të tij, duke siguruar zbatimin e konkluzioneve operacionale dhe rekomandimeve të Komitetit Monitorues. Puna e Komitetit Monitorues do të mbështetet nga një sekretariat teknik i krijuar brenda Zyrës së Mbështetjes së Koordinatorit Kombëtar.

8. Strukturat dhe autoritetet e listuara në nenin 3 do të mbështesin Koordinatorin Kombëtar, duke siguruar që Komiteti Monitorues të marrë në kohë të gjitha informacionet e nevojshme për përmbushjen e detyrave të tij dhe do të garantojnë ndjekjen e konkluzioneve operacionale dhe rekomandimeve të Komitetit Monitorues.

9. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, në bashkëpunim me Koordinatorin Kombëtar, do të konceptojnë, do të zhvillojnë dhe do të mirëmbajnë një modul *software*-ik (REGFIS – Sistemi i Informacionit për Facilitetin e Reformave dhe Rritjes) për menaxhimin, monitorimin, raportimin dhe kontrollin e përgjithshëm të procesit të RGF-së. REGFIS-i do të sigurojë një sistem efikas për ruajtjen e të gjithë informacionit dhe dokumenteve të nevojshme për auditimin, në lidhje me zbatimin e hapave të Reformës. REGFIS-i, ndër të tjera, do të gjenerojë informacionin e nevojshëm për publikimin e të dhënave mbi përfituesit përfundimtarë dhe transmetimin te Komisioni Evropian, në përputhje me nenin 21 të marrëveshjes së facilitetit.

10. Në përputhje me nenin 27, të marrëveshjes së facilitetit, Koordinatori Kombëtar do të mbështesë



vlerësimet pas zbatimit të RGF-së, të kryera nga Komisioni. Koordinatori Kombëtar mund të organizojë, gjithashtu, vlerësime të pavarura të ndërmjetme dhe/ose tematike, në marrëveshje me Komisionin.

Neni 8 Raportimi

1. Koordinatori Kombëtar do të përcaktojë mekanizmat e duhur të raportimit, për të siguruar që raportimi ndaj Komisionit Evropian mbi zbatimin e RGF-së të jetë i plotë dhe gjithëpërfshirës.

2. Koordinatori Kombëtar do të dërgojë informacion të paktën dy herë në vit në Komitetin e Planifikimit Strategjik, duke raportuar mbi progresin e zbatimit të RGF-së, veçanërisht mbi progresin e investimeve të RGF-së.

3. Ministritë e linjës dhe institucionet e tjera publike, të përcaktuara në Agjendën Kombëtare të Reformave si entitete përgjegjëse për zbatimin dhe raportimin mbi arritjen e hapave sipas Agjendës Kombëtare të Reformave, si dhe ministritë e linjës dhe institucionet publike të identifikuar për përgatitjen dhe zbatimin e investimeve në kuadër të Kornizës së Investimeve për Ballkanin Perëndimor, do të përgatisin raporte gjashtëmujore, vjetore dhe çdo raport tjetër të nevojshëm mbi zbatimin e reformave dhe investimeve nën përgjegjësinë e tyre, në gjuhën shqipe dhe me përkthim jozyrtar në gjuhën angleze. Raportet duhet të jenë të strukturuar në mënyrë që të paraqesin qartë, në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të verifikueshme progresin në zbatimin e çdo mase/hapi cilësor ose sasior, si dhe progresin në zbatimin e investimeve.

4. Ministritë e linjës dhe institucionet e tjera publike, të përcaktuara në Agjendën Kombëtare të Reformave si entitete përgjegjëse për zbatimin dhe raportimin mbi arritjen e hapave sipas Agjendës Kombëtare të Reformave, si dhe ministritë e linjës dhe institucionet publike të identifikuar për përgatitjen dhe zbatimin e investimeve, në kuadër të Kornizës së Investimeve për Ballkanin Perëndimor, duhet t'i raportojnë Koordinatorit Kombëtar, si më poshtë:

a) Për masat me afat 6-mujorin e parë të vitit, raportimi duhet të dërgohet pranë Koordinatorit Kombëtar brenda datës 15 qershor të çdo viti raportues;

b) Për masat me afat 6-mujorin e dytë të vitit, raportimi duhet të dërgohet pranë Koordinatorit Kombëtar brenda datës 15 dhjetor të çdo viti raportues.

5. Ministritë e linjës dhe institucionet e tjera publike, të përcaktuara në Agjendën Kombëtare të Reformave si entitete përgjegjëse për zbatimin dhe raportimin mbi arritjen e hapave sipas Agjendës Kombëtare të Reformave, si dhe ministritë e linjës dhe institucionet publike të identifikuar për përgatitjen dhe zbatimin e investimeve në kuadër të Kornizës së Investimeve për Ballkanin Perëndimor, duhet t'i raportojnë Koordinatorit Kombëtar që nuk kanë përfituar financim të dyfishtë për zbatimin e masës, sipas formateve raportuese.

6. Gjatë periudhave të monitorimit, Zyra e Mbështetjes së Koordinatorit Kombëtar kryen analiza periodike të mbështetjes së përfituar nga donatorët/partnerët për masat në zbatim, me qëllim shmangien e financimit të dyfishtë.

7. Struktura e raportimit duhet të përfshijë, të paktën, informacionin e mëposhtëm, në mënyrë shteruese:

a) Titullin dhe referencat numerike të hapit cilësor ose sasior;

b) Gjendjen fillestare të hapit cilësor ose sasior;

c) Afatin për përfundimin e hapit cilësor ose sasior (muaji/viti);

ç) Rezultatet aktuale në arritjen e hapit të reformës, duke përfshirë një analizë të detajuar të progresit të bërë ose një arsyetim për çdo vonesë apo mangësi në zbatim. Kjo analizë duhet të përcaktojë qartë statusin e arritjes së hapit si “plotësisht e arritur”, “e paarritur” ose “pjesërisht e arritur”, të përcaktojë burimin specifik të verifikimit që konfirmon rezultatet e raportuara dhe të përfshijë prova mbështetëse që dëshmojnë arritjet e raportuara.

d) Deklaratën që masat e lidhura me të njëjtat reforma, për të cilat përfituesi kishte arritur një përmbushje të kënaqshme në vendimet e mëparshme, janë të qëndrueshme dhe nuk ka kthim pas.

dh) Provat që mbështesin vlerësimet e kryera nga vetë përfituesi, siç përcaktohet në nenin 14.11 të marrëveshjes së facilitetit, apo çdo provë tjetër shtesë sipas rastit.



Neni 9

Ndryshimet në Agjendën e Reformave

1. Në rastet kur Agjenda e Reformave, duke përfshirë kushtet përkatëse të pagesës, nuk është më e realizueshme, qoftë pjesërisht apo plotësisht, për shkak të rrethanave objektive, Koordinatori Kombëtar do të propozojë miratimin e një agjende të ndryshuar të reformave nga qeveria, me një kërkesë të arsyetuar pranë Komisionit Evropian për ndryshimin e vendimit zbatues që miratoi Agjendën e Reformave dhe programin shumëvjeçar të punës në kuadër të facilitetit për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor.

2. Përpara se të propozojë ndryshime në Agjendën e Reformave, Koordinatori Kombëtar do të paraqesë propozimet për ndryshim pranë Komitetit Monitorues, të justifikuara nga ndryshime objektive të faktorëve në zbatim.

3. Çdo ndryshim në listën e investimeve të miratuara sipas kapitullit 13 të Agjendës së Reformave do të miratohet nga Komiteti i Planifikimit Strategjik.

Neni 10

Menaxhimi financiar

1. Ministria përgjegjëse për financat do të sigurojë zbatimin e duhur të marrëveshjes së huas dhe do të kryejë detyrat e thesarit, sipas marrëveshjes së facilitetit dhe marrëveshjes së huas.

2. Për të zbatuar funksionin e menaxhimit financiar, ministria përgjegjëse për financat:

a) në bashkëpunim me ministritë e linjës do të sigurojë planifikimin buxhetor dhe alokimin e duhur të ndihmës financiare të BE-së brenda buxhetit kombëtar, si dhe përdorimin e rregullt të fondeve të ndihmës financiare në kuadër të Instrumentit RGF, në përputhje me nenet 6 dhe 13–16 të marrëveshjes së facilitetit dhe nenin 4 të marrëveshjes së huas për Instrumentin RGF;

b) do të mirëmbajë dhe do të verifikojë të dhënat financiare dhe pagesat e lidhura me fondet e ndihmës financiare në kuadër të Instrumentit RGF;

c) do të menaxhojë huamarrjen, disbursimin dhe shlyerjen e kredive në përputhje me nenin 20 të marrëveshjes së facilitetit dhe nenin 6 të marrëveshjes së huas;

ç) menjëherë pas përcjelljes së drafteve nga menaxherët e fondeve do të lidhë marrëveshjet e

kontributit dhe do të sigurojë përputhshmërinë me kushtet dhe afatet e shlyerjes. Do të ndjekë procedurat e negocimit, nënshkrimit si dhe përmbushjes së hapave deri në bërjen efektive të marrëveshjeve të kredive/granteve për financim të projekteve në kuadër të paketës financiare për “Lehtësinë e reformës dhe zgjerimit për Ballkanin Perëndimor”;

d) do të sigurojë që kërkesat për disbursim përmbushin kushtet e kërkuara, pas konfirmimit paraprak nga SASPAC-u, në përputhje me nenin 14 të marrëveshjes së facilitetit dhe nenin 7 të marrëveshjes së huas.

3. Ministria përgjegjëse për financat do t’i dorëzojë Koordinatorit Kombëtar kopje të marrëveshjeve të kontributit, të nënshkruara me menaxherët e fondeve dhe provën e disbursimit në Fondin e Përbashkët Evropian për Ballkanin Perëndimor, siç përcaktohet në nenin 20 të marrëveshjes së facilitetit. Koordinatori Kombëtar do t’ia përcjellë këto marrëveshje Komisionit Evropian.

4. Ministria përgjegjëse për financat do të përgatisë, do të bashkënenëshkruajë së bashku me Koordinatorin Kombëtar dhe do t’ia paraqesë Komisionit kërkesat për pagesë sipas marrëveshjes së huas.

5. Ministria përgjegjëse për financat do të sigurojë ndërveprimin e të dhënave ndërmjet regjistrave të saj elektronikë mbi Instrumentin RGF dhe modulit REGFIS, të menaxhuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, duke mundësuar shkëmbim elektronik të të dhënave dhe reduktimin e përpunimit manual dhe gabimeve të mundshme.

Neni 11

Komunikimi, informimi, publiciteti dhe vizibiliteti

1. Koordinatori Kombëtar, në bashkëpunim me Komisionin Evropian, do të hartojë një plan gjithëpërfshirës për komunikimin dhe vizibilitetin.

2. Koordinatori Kombëtar do të jetë përgjegjës për zbatimin dhe koordinimin e planit të komunikimit dhe vizibilitetit, në bashkëpunim me ministritë e linjës apo institucionet e tjera publike, që zbatojnë reformat dhe investimet e listuara në Agjendën Kombëtare të Reformave dhe, në koordinim me Agjencinë për Media dhe Informim,



hartojnë planet përkatëse të komunikimit sipas masave të përcaktuara në Instrumentin RGF.

3. Planet e veçanta të komunikimit i bëhen me dije Koordinatorit Kombëtar dhe Agjencisë për Media dhe Informim 1 (një) muaj pas miratimit të këtij vendimi. Planet e veçanta të komunikimit përditësohen në fund të çdo viti.

4. Çdo ministri e linjës dhe institucion tjetër publik, që zbaton reformat dhe investimet e listuara në Agjendën Kombëtare të Reformave, do të caktojë një koordinator për informimin (komunikimin), i cili do të zbatojë, do të ndjekë dhe do të raportojë mbi planin e komunikimit dhe vizibilitetit sipas masave përkatëse dhe të sigurojë informacion dhe të dhëna për komunikim publik për Zyrën Mbështetëse të Koordinatorit Kombëtar dhe Agjencinë për Media dhe Informim.

5. Mjetet dhe resurset për komunikim në zbatim të planit të komunikimit dhe vizibilitetit mbulohen nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e masave të instrumentit RGF.

Neni 12

Kapacitetet administrative të strukturave dhe autoriteteve

1. Strukturat dhe autoritetet përgjegjëse për funksionet dhe detyrat në kuadër të Instrumentit RGF duhet të sigurojnë personel të mjaftueshëm, me përvojë dhe kompetencë profesionale, për të përmbushur funksionet e këtyre strukturave në përputhje me kërkesat për zbatimin e Instrumentit RGF.

2. Strukturat dhe autoritetet e përcaktuara në nenin 3 të këtij vendimi, do të përgatisin një analizë të ngarkesës së punës për periudhën 2025–2027 për të përcaktuar, ndër të tjera, numrin e punonjësve të nevojshëm për kryerjen e detyrave të tyre në përputhje me kërkesat për zbatimin e Instrumentit RGF. Analiza e ngarkesës së punës duhet të përditësohet çdo vit. Analiza e ngarkesës së punës dhe vendimet e brendshme për përcaktimin e kapacitetit administrativ të nevojshëm duhet t'i komunikohen Koordinatorit Kombëtar.

3. Kapaciteti administrativ duhet të sigurohet brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Institucionet e përcaktuara në nenin 3 duhet të miratojnë dhe/ose të përditësojnë, sipas nevojës, përshkrimet e punës për stafin e caktuar. Përshkrimet e punës duhet të specifikojnë

përqindjen e kohës së dedikuar nga secili punonjës për detyrat e lidhura me Instrumentin RGF.

4. Strukturat përgjegjëse, të cilat ngarkohen me përmbushjen e detyrave nën masat e planit të rritjes brenda institucionit përgjegjës, do të përcaktohen me urdhra të brendshëm të titullarit të institucionit.

5. Koordinatori Kombëtar do të sigurojë trajnime të rregullta për stafin që zbaton Instrumentin RGF.

Neni 13

Procedurat dhe udhëzimet

1. Proceset e përcaktuara në marrëveshjen e facilitetit dhe marrëveshjen e huas do të zbatohen nga strukturat dhe autoritetet e përmendura në nenin 3 të këtij vendimi, bazuar në klauzolat e përcaktuara në marrëveshjen e facilitetit dhe marrëveshjen e huas, të cilat plotësohen nga procedurat kombëtare të RGF-së.

2. Koordinatori Kombëtar dhe ministria përgjegjëse për financat do të përgatisin dhe do të miratojnë procedurat kombëtare të RGF-së për proceset që lidhen me kompetencat përkatëse. Procedurat kombëtare të RGF-së duhet të zbatohen nga të gjitha strukturat dhe autoritetet e parashikuara në këtë vendim, sipas shkronjave “b”, “dh” dhe “e”, të pikës 1 të nenit 3.

3. Manualët e procedurave do të përfshijnë procedura për verifikimin e përmbushjes së hapave dhe objektivave të lidhura me hapat sasiore dhe cilësorë, si dhe përputhshmërinë me parimet horizontale të menaxhimit financiar. Këto procedura do të përfshijnë kontrollin dokumentar, verifikime në terren dhe raporte të jashtme, sipas rastit. Koordinatori Kombëtar do të krijojë procedura përkatëse të zbatueshme për të gjitha strukturat dhe autoritetet e përcaktuara në nenin 3, me qëllim koordinimin e përpjekjeve për të siguruar që fondet në kuadër të facilitetit të përdoren në përputhje me parimet e menaxhimit financiar, transparencës, trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit.

4. Ministria përgjegjëse për financat do të zbatojë procedura të përshtatshme për përgatitjen e deklaratës së sigurisë dhe përmbledhjen e auditimeve dhe kontrolleve të kryera në nivel kombëtar. Këto do të përfshijnë:

a) procedurë për përgatitjen e deklaratës së sigurisë, në përputhje me modelin në aneksin B,



dokumentimin e auditimeve e të kontrolleve, si dhe ruajtjen e informacionit bazë për gjurmën e auditimit;

b) procedura për të siguruar që të gjitha rastet e parregullsive, mashtrimit, korrupsionit dhe konflikteve të interesit që ndikojnë në interesat financiarë të Bashkimit Evropian të raportohen dhe të rikuperohen.

5. Ministria përgjegjëse për financat do të krijojë gjithashtu procedura për të verifikuar raste të mundshme të parregullsive, mashtrimeve, korrupsionit apo aktiviteteve të tjera të paligjshme, përfshirë konfliktet e interesit që ndikojnë në interesat financiarë të Bashkimit Evropian, si dhe raste të financimit të dyfishtë (p.sh. shqyrtime dokumentare, verifikime në terren etj.).

Neni 14

Shkëmbimi i informacionit

1. Të gjitha strukturat dhe autoritetet e përcaktuara në pikën 1, të nenit 3, të këtij vendimi, të cilat janë përgjegjëse për funksionet e caktuara në lidhje me Instrumentin RGF, duhet të sigurojnë brenda juridiksionit të tyre një sistem efektiv për shkëmbimin e informacionit, duke përfshirë regjistrimin elektronik të të dhënave në sistemin/et e menaxhimit të informacionit të krijuar.

2. Shkëmbimi i informacionit mbi mundësinë e financimit të dyfishtë është i detyrueshëm për të gjitha strukturat dhe autoritetet.

Neni 15

Dispozita të fundit

1. Ndryshimet në organigramën e Agjencisë Shtetërore për Programimin Strategjik dhe Koordinimin e Ndihmës (SASPAC) duhet të miratohen brenda 2 (dy) muajve kalendarikë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

2. Hartimi i procedurave dhe manualeve të parashikuara në nenin 13 të këtij vendimi, të përfundojë brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e tij.

3. Ngarkohen strukturat zbatuese të këtij vendimi për nxjerrjen e udhëzimeve dhe urdhrave në zbatim të këtij vendimi.

Neni 16

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 48 lekë

